

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Falsifikoi dhe shiti 1143 ha tokë në Fier, arrestohet Kastriot Hasko, pronari i tokës së sherrit në Palasë! Roli i Lorena Goxhobellit
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/falsifikoi-dhe-shiti-1143-ha-toke-ne-fier-arrestohet-kastriot-hasko-p-i46691
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:45:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6ecb228cc9764087ea1e1a601210436491f83f4758b2bebfb86a2889ff69f72d
TEKSTI	099f7177506d80e07aecdf3bf398a244b5e2ca79b92a5aa6d4bfe606bce82814
PAMJA	30498c24a79fce09e420c9be47af78a19f62bbdbce8332a78122a5a6a751c1ce

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8c064a837c09320d61cd14697f6b863349b366616f7e77dd063e16df985fab11
E MËPARSHMJA	30c12cea88fc842f7cdb09e4acf9779b4129cb4b2bdaa58cd8bd06e6dcb9048e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8c064a837c09320d61cd14697f6b863349b366616f7e77dd063e16df985fab11>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



AKTUALITET

[Falsifikoi dhe shiti 1143 ha tokë në Fier, arrestohet Kastriot Hasko, pronari i tokës së sherrit në Palasë! Roli i Lorena Goxhobellit](#)

17 Shtator 2026, 10:07

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 17 Shtator 2026, 10:07

Falsifikoi dhe shiti 1143 ha tokë në Fier, arrestohet Kastriot Hasko, pronari i tokës së sherrit në Palasë! Roli i Lorena Goxhobellit

Policia ka arrestuar katër persona me urdhër të prokurorisë së Fierit.





Biznesmenët Vasil Bedinaj dhe Luan Muça, bënë sherr për tokën e blerë nga Kastriot Hasko

Katër persona janë arrestuar me urdhër të prokurorisë së Fierit pas zbulimit të një skandali me falsifikimin e dokumenteve për pronat në Seman dhe Sheq Marinas. Në pranga kanë rënë dy ish-drejtorët e Kadastrës, Ertis Shehu dhe Bardh Kapaj, juristi P.Ç dhe biznesmeni Kastriot Hasko i cili ishte përfituesi i pronave.

Zyrtarët akuzohen për falsifikim dokumentesh dhe shpërdorim detyre lidhur me tjetërsimin e pronësive të tokës me sipërfaqe prej 1143 hektarësh.

Hetimet e kryera për procedimin penal të regjistruar në vitin 2025, provuan se Hasko kishte paraqitur si tituj pronësi dy vendime të falsifikuara të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Fier dhe kështu kishte arritur që të regjistronte nën pronësinë e tij dhe të 4 personave të tjerë një sipërfaqe të konsiderueshme toke prej 1,143 hektarë si dhe 150.000 Euro të ndodhur në zonat kadastrale 3301 dhe 3358, Seman i Ri dhe Sheq Marinas, Fier. Veprimet janë kryer në vitin 2024.

Biznesmeni Kastriot Hasko është i njohur më parë për publikun për shkak të një konflikti të bujshëm gjyqësor dhe mediatic rreth një sipërfaqeje prej 37 hektarësh tokë në Palasë ku u përplasën me armë biznesmenët Luan Muça dhe Vasil Bedinaj. Ai raportohet se ishte pronari i tokës së shitur në Palasë.

Në hetimin e prokurorisë së Fierit, u zbulua se Hasko duke falsifikuar prokurën nga personat e tjerë bashkëpronarë për tokat në Seman dhe Sheq Marinas, ua ka shitur këtë tokë dy kompanive të ndryshme. Skandali është zbuluar dy muaj pasi Lorena Goxhobelli kishte marrë detyrën si drejtore të përgjithshme të Kadastrës.

Dy ish-drejtorët e Kadastrës, Ertis Shehu dhe Bardh Kapaj dhe juristi P.Ç e kanë regjistruar pronën në kundërshtim me ligjin duke mos kërkuar konfirmimin e vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, verifikim nga i cili do provohet se K.H kishte falsifikuar dokumentet.

Jo vetëm kaq, por ish-drejtori Bardh Kapaj kur ka regjistruar pasurinë ka tejkaluar edhe sipërfaqen që i ishte kthyer ish-pronarit Th.S duke bërë që K.H të përfitonte edhe më shumë sipërfaqe toke nga ajo që ishte tjetërsuar.


Ish-drejtori tjetër Ertis Shehu dhe juristi P.Ç kanë ndryshuar zërin kadastral të sipërfaqes së regjistruar në pronësi të K.H nga tokë arë në tokë pa frut pa patur asnjë akt administrativ nga qeveria apo ministria e Bujqësisë.

Në kuadër të hetimeve u sekuestruan mbi 76 pasuri, me sipërfaqe totale prej 1143 hektarë tokë (e barabartë me njëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e gjashtë m²), si dhe 150.000 euro. **Versus.al**

Tags:

[pronat fier kadastra ertis shehu](#)

Poll



AKTUALITET

[Rrugosi me draper babam e ish-te dashtures, miet ne burg uaja i Zegjine Gausmi](#)

17 Shtator 2026, 10:24

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Me 13 lingota e monedha floriri kontrabandë dhe mijëra euro në 'Porsche', arrestohet i riu në Fier](#)

17 Shtator 2026, 09:52

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Incesti me të miturën në Tiranë, kushëriri dhe tezja e saj filmonin aktin me telefon! E zbuluan mësuesit e shkollës](#)

17 Shtator 2026, 09:34

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Sherr me thika në Sarandë, pl*gosen 3 persona, mes tyre dy vëllezër](#)

17 Shtator 2026, 08:45

^ekstrakti^





AKTUALITET

Tronditëse në Tiranë! Zbulohet rast incesti, 12 vjeçarja u abuzua seksualisht nga kushëri i dhe tezja e saj

17 Shtator 2026, 08:11

^ekstrakti^



AKTUALITET

EMRAT/ Hetimet për falsifikim pronash në bregdetin e Semanit, arrestohet pronari i “Moncafe” dhe ish-kreu i Kadastrës Fier

16 Shtator 2026, 21:40

^ekstrakti^




AKTUALITET

“Ky popull paska pas SPIUNA”, shpërthen Leonora Jakupi pas vendimit të Hagës: 90% e dëshmitarëve ishin shqiptarë!

16 Shtator 2026, 21:14

^ekstrakti^



AKTUALITET

Vendimi i Hagës/ Dua Lipa publikon bilancin e luftës së Kosovës: 11 mijë të vrarë mes tyre dhe fëmijë, 20 mijë të dhunuar dhe 1 mln refugjatë!

16 Shtator 2026, 20:54

^ekstrakti^

Të fundit





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.